



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
01.07.2015			
Emri i Komunitetit	Numri i Doku	Emri i Kryetarit	Adresa
	01-013/917		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 5.1.1 të Ligjit për mbrojtje nga zjarri nr. 04/L-012 dhe nenit 36 paragrafi 2 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2015 miraton këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI
PËR KOMUNËN E VITISË

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Planin për mbrojtje nga zjarri për komunën e Vitisë.

Neni 2

Obligohen të gjitha institucionet komunale, Arsimore, Shëndetësore, subjektet afariste dhe qytetarët e Komunës së Vitisë që ta zbatojnë planin e mbrojtjes nga zjarri për Komunën e Vitisë.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani për mbrojtje nga zjarri për Komunën e Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Shërbime publike,
2. Shërbimit të Kuvendit
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Naim Pira

